



P Z A P
I P Ž P

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.58/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Bujar Muzaqi kryesues, Hajriz Hoti dhe Kujtim Pasuli anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 19.01.2025, merr këtë:

V E N D I M

I. Pranohet e bazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, Anr.58/2025 e datës 17.01.2025.

II. Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, i shqiptohet dënim i gjelbë më lartësi prej 4.000.00, (katërmijë) €uro.

III. Detyrohet Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, që gjobën e shqiptuar si në pikën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

A r s y e t i m

Me datë 17.01.2025 PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë me të cilën pretendon se më 16 janar 2025, në fshatin Komogllavë të Ferizajt, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), ka vendosur baner/posterë në hapësirat publike të kryetarit te LDK-së Lumir Abdixiku dhe të kandidatit për deputet Visar Azemi. Të tutje në ankesë theksohet se ky veprim i subjektit politik LDK, është në kundërshtim me |nenin 34 paragrafi 2 I LZP-së Përmes këtij veprimi, subjekti përkatës, ka cenuar rëndë dispozitat përkatëse ligjore. Andaj, duke u mbështetur në bazën ligjore dhe argumentum e lartcekura, kërkojnë që masa e sanksionit të vendoset në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Si provë parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur një fotografi që dëshmon vendosjen e banerë/posterëve në kundërshtim me rregullativën zgjedhore.

Më datë 17.01.2025, PZAP-i, e njoftoi subjektin politik Lidhja Demokratike të Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, për ankesën e paraqitur kundër tyre, duke i dërguar kërkësë për përgjigje deri me 18.01.2025 në ora 12:00.

Në përgjigje në ankesë të paraqitur me datë 18.01.2025, subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), ka kundërshtuar ankesën e paraqitur nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) lidhur me pretendimet e theksuara në ankesë dhe në të njëjtën kohe e ka larguar banerin nga vendi ku ka qene iu vendosur gjegjësisht e ka larguar nga rruga publike.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoi ankesën gjeti se :

-Ankesa është e bazuar.

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës dhe përgjigjes në ankesë të paraqitur nga Subjekti Politik LDK, vlerësoj se pretendimet e Subjektit Politik LVV, janë të qëndrueshme dhe si të tilla i aprovoj përfaktin se veprimet e përshkruara në ankesë paraqesin shkelje të dispozitës së nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 i Ligjit NR.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, ku parashihet se “*Vendosja e njoftimeve, pllakateve dhe posterëve, ose përndryshe vendosja e emrave të tyre ose sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave në apo mbi rrugët publike, në shenjat publike të trafikut brenda ose jashtë hapësirave ose ndërtesave të zëna ose ndryshe që shfrytëzohen nga organizatat ndërkombëtare ose brenda ose ne hapësirat private pa lejen e pronareve ose shfrytëzuesve.*”

Kjo përfaktin se në përgjigje në ankesës Subjekti Politik LDK i referohet vetëm përgjigjes pozitive verbale nga KKZ se mund të vendosen posterë të tillë dhe se të njëjtin vend janë vendosur edhe reklama biznesi, por nuk ka vërtetuar me asnjë dëshmi që iu është lejuar vendosja e posterëve të subjektit të tyre politiko përfushatë zgjedhore.

Paneli, me rastin e vendosjes së gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrëthanat si në vijim : natyrën e shkeljes, dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë, shkallën dhe peshën e shkeljes, se ky veprim i tyre përbën përsëritje të shkeljes së legjislacionit zgjedhor, pra ka bërë shkelje të tillë edhe në proceset e mëparshme zgjedhore. Kjo konsiston në faktin se Subjekti Politik LDK, ka qenë i njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës zgjedhore. Andaj përfshirja e posterëve të subjektit të tyre politik përfushatë zgjedhore në hapësira shtetërore gjegjësisht mbi rrugën publike në fshatin Komogllave te Ferizaj, përbën shkelje të legjislacionit zgjedhor, saktësisht e sankzionuar me dispozitën e lartë cekur të rregullës zgjedhore, dhe të njëjtit subjekt politik përfshirja e posterëve të subjektit të tyre politiko përfushatë zgjedhore.

Paneli, me rastin e vendosjes së gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrëthanat si në vijim: natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë, shkallën dhe peshën e shkeljes, se ky veprim i tyre përbën shkelje të tillë edhe në fshatin Komogllave te Ferizaj, përbën shkelje të legjislacionit zgjedhor, saktësisht e sankzionuar me dispozitën e lartë cekur të rregullës zgjedhore, dhe të njëjtit subjekt politik përfshirja e posterëve të subjektit të tyre politiko përfushatë zgjedhore.

legjislacionit zgjedhor. Kjo konsiston në faktin se Subjekti Politik LDK, ka qenë i njofuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës zgjedhore dhe se këto veprime përbëjn shkelje të legjislacionit zgjedhor, saktësisht e sankzionuar me dispozitën e nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit NR.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Paneli po ashtu me rastin e përcaktimit për lartësinë e gjobës, ka marr parasysh edhe përgjigjen në ankesë të subjektit politik LDK, ku nga fotot e printuara të bashkangjitura përgjigjes në ankesë, dëshmohet se janë larguar posteret e kandidatëve për deputet nga radhët e këtij subjekti, në hapësira shtetërore gjegjësisht mbi rrugën publike në fshatin Komogllavë të Ferizaj, dhe kjo vlerësohet nga ana e panelit ndërmarrje e masave përmirësuese, e cila pastaj ka rezultuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendim.

Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se: “*vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse*”, Paneli vlerësoj se pretendimet e tillë janë të qëndrueshme dhe si të tillë i pranoi, sepse kjo shkelje ka të bëjë me faktin se Kodi i Mirësjelljes i detyron të gjitha subjektet politike, kandidatët, anëtarët e subjekteve dhe mbështetësit e tyre që ta respektojnë këtë kod me qëllim të krijimit të kushteve që gjatë periudhës së fushatës, veprimet e subjekteve politik të jenë në një atmosferë të tolerancës demokracisë, paqes dhe respektit për sundimin e ligjit se nga veprimet e përshkruara në ankesë nga parashtruesi i ankesës paraqesin shkelje të dispozitave të lartcekura, dhe të njëjtën e pranoi si të bazuar.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 dhe neni 120 paragrafi 1 nen parafë 1.3 të LZP-së, të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.58/2025 datë 19.01.2025



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së.